



Republika e Kosovës-  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

REPUBLIKA E KOSOVES- REPUBLICA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO  
AUTORITETI KOMBËTAR I KUALIFIKIMEVE  
NACIONALNI AUTORITET ZA KVALIFIKACIJE  
NATIONAL QUALIFICATION AUTHORITY  
Hr. Prot.: 011196 Data: 25.05.2021  
Br. Prot.: Datum:  
Prot. No.: Date:  
PRISHTINË/PRIŠTINA/PRISTINA



Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve  
Nacionalni Autoritet za Kualifikacije  
National Qualification Authority

Bazuar në nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare Nr. 03/L-060, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve nxjerr:

## Rregulloren e punës të Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve

### Neni 1

#### Dispozitat e përgjithshme

Me këtë rregullore përcaktohet mënyra e punës, (thirrja dhe mbajtja e mbledhjeve, mënyra e vendimmarrjes, zgjedhja dhe shkarkimi i Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit të Këshillit Drejtues), dhe çështjet e tjera relevante.

### Neni 2

#### Këshilli Drejtues

Bazuar në nenin 8 dhe 9 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (Ligji Nr. 03/L-060, datë 7 Nëntor 2008), Këshilli Drejtues është organe vendimmarrës i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve (tash e tutje AKA).

### Neni 3

#### Përbërja dhe zgjedhja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues përbëhet nga 13 anëtarë nga radhët e të dy gjinive.
2. Përbërja e Këshillit Drejtues aprovet nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
3. Drejtori i AKA-së është anëtar ex-officio i Këshillit Drejtues dhe vepron si sekretar i këtij këshilli pa të drejtë vote.
4. Anëtarët e Këshillit Drejtues jenë të deleguar nga institucionet përkatëse të përcaktuara në pikën 2 të nenit 8 të Ligjit për Kualifikimet Kombëtare (Ligji Nr. 03/L-060).
5. Anëtarët e Këshillit Drejtues ushtrojnë detyrën e tyre bazuar në dispozitat ligjore në fuqi, respektimin e plotë të lirisë dhe pavarësisë profesionale, si dhe duke u bazuar në standarde të larta etike.

Neni 4  
Mbledhja konstituive

1. Mbledhjen konstituive të Këshilli Drejtues e thërret drejtori i AKK, të cilën e udhëheq anëtari me i vjetër në moshë i Këshilli Drejtues deri ne zgjedhjen e Kryetarit dhe zëvendës Kryetarit.
2. Në mbledhjen e parë të Këshilli Drejtues, drejtori i AKK-së i prezanton anëtarët, bazuar ne vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës për emërimin e tyre.
3. Këshilli Drejtues e zgjedh Kryetarin dhe zëvendës kryetarin nga radhët e veta. Kryetari dhe zëvendës kryetari i Këshillit Drejtues zgjedhën me shumicë të votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshilli Drejtues.
4. Mandati i Kryetarit dhe zëvendës kryetarit është i njëjtë me mandatin që u është dhënë me vendimin e Qeverisë për emërimin e tyre si anëtarë të Këshillit Drejtues.
5. Secili anëtarë i Këshilli Drejtues ka të drejtë për të kandiduar për pozitën e Kryetarit dhe zëvendës kryetarit, çoftë duke u propozuar nga anëtarët e tjerë, apo duke u vetë-propozuar.
6. Zgjedhja e kryetarit dhe zëvendës kryetarit bëhet me vota të fshehta. Nëse propozohet vetëm një kandidatë për kryetar apo zëvendës kryetar, atëherë Këshilli Drejtues vendos për formën e votimit.
7. Në këtë rast Këshilli Drejtues formon një komision prej tre anëtarësh të cilët do ta organizojnë procesin e votimit. Për përbërjen e këtij komisioni vendos Këshilli Drejtues, me vota te hapura.
8. Nëse në raundin e parë, asnjë nga kandidatët nuk merr numrin e mjaftueshëm të votave për tu zgjedhur Kryetar apo zëvendës kryetar, atëherë organizohet raundi i dytë me dy kandidatët të cilët kanë marrë numrin me të madh të votave në raundin e parë. Nëse edhe në raundin e dytë apo të tret nuk arrihet te zgjidhët Kryetari dhe zëvendës kryetari, atëherë Këshilli Drejtues do të kryesohet nga anëtari me i vjetër në moshë për tre muajt e ardhshëm.
9. Pas tre muajve përsëritet votimi për zgjedhjen e Kryetarit dhe zëvendës kryetar, deri ne momentin kur njëri nga kandidatet merr numrin e mjaftueshëm të votave për këto pozita.
10. Nëse për çfarëdo arsyeje Këshilli Drejtues mbetet pa Kryetarit dhe zëvendës kryetar, çoftë për shkak të dorëheqjes së tyre apo shkarkimit, e njëjta procedurë zhvillohet për zgjedhjen e Kryetarit dhe zëvendës kryetarit të ri.
11. Shkarkimi i Kryetarit apo zëvendës kryetarit bëhet me propozimin e të paktën 1/3 e anëtarëve të numrit të përgjithshëm të Këshillit Drejtues. Vendimi për shkarkim e Kryetarit apo zëvendës kryetarit të Këshillit Drejtues merret me 2/3 e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit Drejtues.



## Neni 5

### Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues

1. Këshillit Drejtues, si organ kolegjal ka përgjegjësi të plotë në zhvillimin e politikave dhe vendimmarrjen e proceseve të ndërlidhura me Kornizën Kombëtare të Kualifikimeve (KKK).
2. Përcakton objektivat kryesore të procesit të akreditimit të Institucioneve, validimit të kualifikimeve, Njohjen e Mësimit Paraprak (NjMP) dhe verifikimin e standardeve të profesioneve.
3. Me propozim e Drejtorit të AKK-së, Këshillit Drejtues aprovon listën e eksperteve të jashtëm për vlerësimet të Institucioneve, kualifikimeve, NjMP dhe verifikimin e standardeve të profesionit .
4. Shqyrton kërkesat dhe aprovon aplikacionet për akreditim, validim dhe verifikim mbi bazën e procedurave dhe kritereve të miratuara.
5. Merr vendime për akreditimin e institucioneve, aprovimin e kualifikimeve, akreditimin për zbatimin e NjMP dhe verifikimin e standardeve të profesionit duke u bazuar në raportet e hartuara nga ekipet e ekspertëve.
6. Vendosë për kohëzgjatjen e akreditimit të Institucioneve, validimit të kualifikimeve dhe verifikimit të standardeve të profesionit sipas rekomandimeve të ekspertëve të jashtëm.
7. Merr vendim edhe ne rastet e monitorimit bazuar në rekomandimin e ekipit të ekspertëve.
8. Shqyrton ankesat e institucioneve dhe merr vendim lidhur me to sipas Udhëzimit Administrativ përkatës.
9. Sipas nevojës, Këshillit Drejtues mund të formoj grupe punuese për çështje të caktuara dhe që mund të ndihmojnë AKK-në me ekspertiza te nevojshme.
10. Bën interpretimin e akteve që i miraton.
11. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe zëvendës kryetarin.

## Neni 6

### Aktet e Këshillit Drejtues

1. Këshillit Drejtues nxjerr dhe miraton:
  - Rregullore,
  - Vendime
  - Rekomandime, dhe
  - Politika për AKK dhe Korniza Kombëtare e Kualifikimeve (KKK).



2. Këshillit Drejtues jep interpretim autentik të akteve që miraton.

## Neni 7

### Njoftimi për mbajtjen e mbledhjes

1. Anëtarët e Këshillit Drejtues për mbajtjen e mbledhjeve të rregullta do të njoftohen së paku shtatë ditë para mbajtjes se mbledhjes. Ftesat mund të bëhen me shkrim, me e-mail, ose në çfarëdo forme tjetër me të cilën dërgesa dhe informimi janë të sigurt. Të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues janë të obliguar të marrin pjesë në mbledhje.
2. Bashkë me njoftimin për mbajtjen e mbledhjes, anëtarëve të Këshillit Drejtues do tu dërgohet edhe agjenda e takimit, bashkë me të gjitha materialet relevante të cilat do të trajtohen në takimin e radhës.
3. Ftesa për mbajtjen e mbledhjes se jashtëzakonshme duhet tu dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues të paktën 48 orë para mbajtjes se takimit.
4. Mbledhjet e Këshillit Drejtues mbahen më prezencë fizike, virtuale, apo të kombinuar. Për mënyrën e pjesëmarrjes vendos vetë anëtari. Nëse një anëtarë i Këshillit Drejtues vendos për pjesëmarrje virtuale, paraprakisht duhet ta njoftoi kryetarin e Këshillit Drejtues para fillimit të takimit. AKK është e obliguar krijojë kushte teknike për pjesëmarrje të anëtarit në mënyrën virtuale në takimin e Këshillit Drejtues.

## Neni 8

### Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Mbledhjen e Këshillit Drejtues e thërret dhe i kryeson Kryetari. Kryetari i Këshillit Drejtues përfaqëson Këshillin Drejtues në të gjitha nivelet, vendore e ndërkombëtare, nënshkruan vendimet e Këshillit Drejtues, dhe kryen detyrat e tjera të përcaktuara me dispozitat ligjore në fuqi dhe ato të caktuara nga Këshillin Drejtues.
2. Në rast të mungesës së Kryetarit, mbledhjen e kryeson zëvendës kryetari. Nëse edhe zëvendës kryetari nuk ka mundësi të marr pjesë në mbledhje, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Këshillit Drejtues sipas moshës.
3. Mbledhjet e rregullta të Këshillit Drejtues mbahen së paku 6 herë në vit. Mbledhjet e Këshillit Drejtues mund të jenë të rregullta dhe të jashtëzakonshme. Sipas nevojës, Kryetari mund të thirr mbledhje të rregullta apo të jashtëzakonshme.
4. Mbledhje të rregullt dhe të jashtëzakonshme mund të propozojnë edhe nga 1/3 e anëtarëve të Këshillit Drejtues. Në rast se Kryetari apo zëvendës kryetari nuk marrin parasysh kërkesën e tyre për thirrjen e mbledhjes brenda tri (3) ditësh nga kërkesa e anëtarëve të Këshillit Drejtues, këta të fundit mund të thërrasin mbledhje të rregullta apo të jashtëzakonshme. Kjo kërkesë duhet të jetë e arsyetuar me shkrim, dhe të



sqarohen pikat te cilat do te jenë objekt i trajtimit ne mbledhjen e kërkuar nga ana e tyre.

5. Mbledhjet e jashtëzakonshme mund të mbahen në çfarëdo kohe sipas legjislacionit në fuqi. Rendi i ditës për këtë mbledhje propozohet nga Kryetari, apo nga propozuesit për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme. Gjatë mbledhjes së Këshillit Drejtues mund të vendoset për thirrjen e ndonjë mbledhje të ardhshme.
6. Gjatë mbledhjeve të Këshillit Drejtues anëtarët duhet të votojnë personalisht dhe nuk lejohet delegimi i votës. Në raste të veçanta, në pamundësi të prezencës fizike mund të votohet edhe nga distanca në formë elektronike, me kusht që ky votim të dërgohet tek të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues.
7. Para se të fillojë mbledhja e Këshillit Drejtues, anëtarët do të nënshkruhen në listën e pjesëmarrjes e cila është pjesë integrale e procesverbalit. Anëtari i Këshillit Drejtues mund të mungojë nga mbledhja për shkaqe të arsyeshme. Për mosardhje në mbledhje anëtari i Këshillit Drejtues duhet ta njoftojë me kohë kryetarin.
8. Ndaj anëtarit të Këshillit Drejtues i cili mungon në tri mbledhje brenda vitit pa paralajmërim dhe arsyeje, Këshillit Drejtues ka të drejtë ti propozoi Qeverisë shkarkimin e tij.
9. Me ftesë të Këshillit Drejtues, në takime mund të marrin pjesë edhe zyrtarë të tjerë të AKK-së, apo ekspertet te cilët kanë trajtuar çështjen te cilën Këshilli Drejtues do ti diskutoi.
10. Nëse Këshillit Drejtues vendos të ftojë persona të cilët nuk janë pjesë e AKK-së, atëherë kjo ftesë paraprakisht duhet te votohet nga Këshillit Drejtues.
11. Mbledhjet e Këshillit Drejtues janë të mbyllura, në përjashtim të rasteve kur Këshilli Drejtues vendos ndryshe.

## Neni 9

### Mbarëvajtja e mbledhjeve të Këshillit Drejtues

1. Kryetari e hap, e kryeson, e ndërpret dhe e përfundon mbledhjen. Rendi i ditës për mbledhjen, përgatitet nga Kryetari i Këshillit Drejtues dhe Drejtori i AKK-së.
2. Në fillim të mbledhjes Kryetari konstaton se a ka kuorum, propozon rendin e ditës, , hap diskutimin rreth rendit të ditës, dhe konstaton miratimin e rendit të ditës i cili votohet nga e Këshillit Drejtues. Për mbajtjen e mbledhjeve të Këshillit Drejtues nevojitet kuorumi prej të paktën shtatë (50+1) anëtarëve.
3. Anëtarët e Këshillit Drejtues kanë drejtë të propozojnë ndryshimin dhe plotësimin e rendit të ditës, duke arsyetuar propozimin. Ky propozim votohet nga e Këshillit Drejtues.

4. Kryetari i jep fjalën diskutuesit, konstaton mbylljen e shqyrtimit të temës së caktuar, çështjen e vë në votim, konstaton miratimin ose refuzimin e propozimit. Pas miratimit të rendit të ditës, kalohet në shqyrtim dhe vendosje për çështjet që janë në kuadër të pikave të miratuara të rendit të ditës.
5. Raportin dhe arsyetimin rreth secilës pikë të rendit të ditës e paraqet Kryetari, Drejtori i AKK-së ose personi i caktuar nga Kryetari, pas të cilit Kryetari e hap diskutimin. Të gjithë anëtarët e pranishëm të Këshillit Drejtues mund të marrin pjesë në diskutim dhe të paraqesin mendimet, propozimet, lidhur me çështjet të cilat do të vendosen në mbledhje.
6. Kryetari jep fjalën sipas radhës së paraqitjes për diskutim. Çdo anëtar i Këshillit Drejtues ka të drejtë të kërkoj sqarime për temën e caktuar.
7. Kryetari kujdeset për mbarëvajtjen e takimit të Këshillit Drejtues. Kryetari ka të drejtë të kërkojë nga folësit që t'i përmbahen temës. Kryetari ka të drejtë të ndërpresë mbledhjen nëse ai konstaton se nuk ka kushte normale për mbajtjen e mbledhjes.
8. Për shkeljen e rendit në mbledhje mund të shqiptohen këto masa: Vërejtje, Marrja e fjalës dhe largim nga mbledhja.
9. Vërejtje me gojë mund t'i shqiptohet të pranishmit nëse me sjelljen dhe diskutimin e tij çrregullon dhe pengon punën normale të mbledhjes.
10. Marrja e fjalës i shqiptohet anëtarit të Këshillit Drejtues, i cili me sjelljet dhe deklaratat e tij çrregullon punën normale të Këshillit Drejtues për të cilën më parë i është shqiptuar vërejtje.
11. Vërejtjen dhe marrjen e fjalës i shqipton kryesuesi.
12. Largimi nga mbledhja i shqiptohet pjesëmarrësit nëse edhe pas marrjes së fjalës pengon mbarëvajtjen e mbledhjes. Largimin nga mbledhja e shqipton Këshillit Drejtues me shumicë votash. Pjesëmarrësit të cilit i është shqiptuar kjo masë është i detyruar që menjëherë të lëshojë mbledhjen. Largimi nga mbledhja bëhet vetëm për atë mbledhje.

## Neni 10

### Marrja e Vendimeve nga Këshilli Drejtues

1. Para se të votohet një pikë e rendit të ditës, kryesuesi, e formulon propozimin e vendimit ose të kërkesës lidhur me atë pikë të rendit të ditës. Pas shqyrtimit dhe përfundimit të diskutimeve, sipas pikës së rendit të ditës, Këshillit Drejtues merr vendim.
2. Këshillit Drejtues i merr vendimet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve me të drejtë vote. Votimi bëhet i hapur me ngritje dore ose me vota të fshehta. Se si do të bëhet votimi, Këshillit Drejtues vendos në mbledhjen përkatëse.
3. Votimi bëhet: "për", "kundër" apo "abstenim".



4. Pas votimit në bazë të rezultateve të votimit, Kryetari konstaton se propozimi i vendimit është miratuar ose është refuzuar.
5. Nëse një propozim ka marrë vetëm 50% të votave (ne rastet kur ne mbledhje marrin pjesë 12 anëtarë), atëherë vota e Kryetarit është përcaktuese (vota deblokuese).
6. Në bazë të propozimit të Kryetarit, apo ndonjë anëtar, Këshilli Drejtues mund të vendosë që shqyrtimi për disa çështje specifike të ndërpritet dhe të përgatitet më hollësisht për mbledhjen e ardhshme.

#### Neni 11

#### Humbja e mandatit të anëtarit të Këshilli Drejtues

1. Mandati i anëtarit të Këshilli Drejtues humbet në këto raste:
  - 1.1 Me dorëheqjen nga Këshilli Drejtues;
  - 1.2 Me tërheqjen e anëtarit nga institucioni delegues;
  - 1.3 Me shkarkimin e tij nga Qeveria e Republikës së Kosovës
  - 1.4 Nëse konstatohet se me vetëdije si anëtarë i Këshillit Drejtues ka votuar në konflikt të interesit, dhe
  - 1.5 Me vdekjen e anëtarit të Këshilli Drejtues.
2. Nëse një anëtar e humb statusin e anëtarit të Këshillit Drejtues sipas rasteve të përcaktuara më lartë, për pozitën vakante institucioni përfaqësues emëron një tjetër anëtar, i cili duhet të merr aprovimin në Qeverinë e Republikës së Kosovës.

#### Neni 12

#### Mbajtja e procesverbalit të mbledhjeve të Këshillit Drejtues

1. Në çdo mbledhje të Këshillit Drejtues mbahet procesverbal. Procesverbali nënshkruhet nga Kryetari dhe procesmbajtësi.
2. Procesverbali duhet të përmbajë këto elemente:
  - 2.1 vendin, datën dhe kohën e fillimit dhe mbarimit të mbledhjes;
  - 2.2 rendin e ditës;
  - 2.3 listën e pjesëmarrësve dhe atyre që mungojnë;
  - 2.4 të gjitha propozimet dhe rezultatet e votimeve përkatëse;
  - 2.5 shënimet thelbësore mbi rrjedhën e mbledhjes;
  - 2.6 dokumentet shtesë duhet t'i bashkëngjiten procesverbalit si aneks.



3. Procesverbali duhet të përgatitet pas mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe si ekstrakt duhet t'iu dërgohet anëtarëve të Këshillit Drejtues me rastin e dërgimit të materialit për mbledhjen e ardhshme.
4. Para aprovimit të procesverbalit nga Këshillit Drejtues, anëtarët e tij mund të kërkojnë përmirësimin e tij. Procesverbali miratohet në mbledhjen e ardhshme të Këshillit Drejtues.
5. Procesverbali ruhet në arkiv të AKK-së sipas dispozitave ligjore në fuqi, bashkë me materialet e tjera të takimit sipas pikave të rendit të ditës.

### Neni 13

#### Konflikti i interesit

1. Te gjithë anëtarët e Këshilli Drejtues janë të detyruar të deklarojnë rastet kur ata janë në konflikt të interesit, dhe ta lëshojnë mbledhjen. I njëjti nuk ka të drejtë të marr pjesë as në diskutim e as në vendimmarrje të asaj çështje.
2. Konflikt i interesit trajtohet sipas nenit 6 të Ligjit mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publikë (Ligji Nr. 06/L -011, datë 30 mars 2018), sipas të cilit: *"Konflikti i interesit lind nga një rrethanë në të cilën zyrtari ka interes privat, që ndikon, mund të ndikojë ose duket se ndikon në kryerjen me paanshmëri dhe objektivitet të detyrës së tij zyrtare."*
3. Interesi privat i referuar në pikën 2 të këtij neni, trajtohet sipas nenit 3 të Ligjit mbi parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publikë.
4. Nëse anëtari i Këshillit Drejtues me vetëdije ka votuar apo ka marrë pjesë në diskutim edhe pse e ka ditur që ka konflikt të interesit, atëherë kjo situatë trajtohet sipas nenit 417 (Konflikti i interesit) të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr. 06/L -074, datë 23 nëntor 2018).

### Neni 14

#### Mbikëqyrja e zbatimit dhe interpretimi i rregullores


1. Për zbatimin e drejtë të kësaj Rregulloreje kujdeset Kryetari Këshillit Drejtues.
2. Dispozitat e kësaj Rregulloreje vlejnë për të gjithë anëtarët e Këshillit Drejtues dhe personave të tjerë të cilët mund të marrin pjesë në takimet e Këshillit Drejtues.
3. Interpretimin e kësaj rregullore, sipas nevojës e bën Këshilli Drejtues.
4. Këshillit Drejtues për mënyrën e interpretimit të rregullores vendos më shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve.





**Neni 15**  
**Dispozitat kalimtare**

1. Kjo rregullore hynë ne fuqi pas miratimit nga Këshilli Drejtues, dhe nënshkrimit te saj nga ana e kryetarit të Këshilli Drejtues.
2. Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet rregullorja e punës e Këshillit Drejtues të Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me Nr. 470/01, të datës 13.11.2014.
3. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregulloreje mund të bëhet sipas procedurës së njëjtë të nxjerrjes.



**Prof. Dr. Agron Bajraktari**

**Kryetari i Këshillit Drejtues te AKK**